



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Procesverbal i Mbledhjes së I-të të KMCV

Në Universiteti "Kadri Zeka", e cila është mbajtur të mërkurën më **09.12.2020 në ora 13.00**, në zyrën e Prorektorit për mësim, me këtë:

REND DITE

1. Konstituimi i KKMCV
2. Njoftimi për detyrat dhe përgjegjësitë e KMCV
3. Shqyrtim i dokumenteve të nevojshme për cilësinë në UKZ, dhe ndërmarrja e masave-ndarja e detyrave
4. Te ndryshme

Në mbledhje ishin të pranishëm: Prof.Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi (Prorektor për mësim, kërkime shkencore dhe çështje të studentëve), Prof.Ass.Dr. Fatmire Krasniqi (Prodekane e Fakultetit Juridik), prof..ass.dr. Shefket Jakupi (prodekan në Fakultetin Ekonomik), Fitore Malaj (drejtore e ZZHA), dhe Refik Ibrahimimi (zyrtar i zyrës për çështje akademike)

Munguan: prof.ass.dr. Bashkim Dalipi (F. Edukimit), prof.dr. Ragmi Mustafa (prodekan i FSHK) dhe përfaqësuesit e studentëve.

Ecuria e Mbledhjes:

1. Aprovimi i Vendimit të Senatit të UKZ të datës 07.12.2020, lidhur me Miratimin e Rregullores për Themelimin e KMCV. Përbërja e KMCV. Të pranishmit u pajtuan me vendimin e Senatit dhe përbërjen e Këshillit KMCV.

2. Kryesuesi i Mbledhjes, Prof.asoc.dr. Xhevdet Thaqi, i njoftoi të pranishmit me detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KMCV dhe rëndësinë e këtij Këshilli. U theksuan detyrat e caktuara bazuar ne Rregulloren [për Themelimin e KMCV nga Senati i UKZ.
3. Pas një shqyrtimi të gjendjes aktuale të rregulloreve dhe punës që e bënë ZZHA, të cilën e raportoi Drejtori i ZZHA (Fitore Malaj), u pajtuam që:
 - Të bëhet një Rishikim i Rregullores aktuale për procedurat për sigurimin e cilësisë (afati e diel, 13.12.2020, afati për dorëzimin e draft propozimit të punuar nga F. Malaj dhe Xh. Thaqi)
 - Të hartohet një Rregullore e punës së Këshillit KMCV (deri te hënën, 14.12.2020, drafti i parë i propozimit nga Refik Ibrahimimi)
 - Në konsultim me Dekanin Shpresë Qamili, të harmonizohet puna në hartimin e Udhëzuesit për ECTS, dhe të jetë gati për Mbledhjen e dytë të KMCV.
 - Të përgatiten Pyetësorët për vetëvlerësim të stafit akademik (afati 0.12.2020) dhe të u dërgohen stafit akademik të UKZ për plotësimin e tij, në mënyrë që të përgatitet Raporti i cili publikohet në WebFaqe të UKZ.(Fitorja, Xhevdeti)
 - Të hartohet Manuali për vlerësimin e Stafit akademik në UKZ.
4. Në pikën e katërt të rendit-të ndryshme, anëtarët e komisionit diskutuan lidhur me inkorporimin e të dhënave të nevojshme për RVV, dhe u caktua mbledhja e radhës për të Martën, më 15.12.2020, kur edhe do të finalizojmë versionin e rregulloreve për cilësi, për punën e KMCV, formularët etj.

Mbledhja përfundoi në ora 14:50.

Procesverbalin e e përpiloi
Fitore Malaj

Kryetari i KMCV
Prorektori për Mësim, Kërkime Shkencore dhe
Çështje të Studentëve

Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi